


MANUAL PRAKTIK

KOMUNIKIMI, GJUHA DHE TË FOLURIT

Udhëzues për mësimdhënës dhe edukatorë

INKLUZIONI • GJILAN • 2026

INKLUZIONI
CENTER FOR SOCIAL INCLUSION AND INNOVATION

INKLUZIONI • KOMUNA E GJILANIT

TË DHËNAT E BOTIMIT

Titulli	**Manual praktik: Komunikimi, gjuha dhe të folurit**
Nëntitulli	Udhëzues për mësimdhënës dhe edukatorë
Autorë	Altinë Mehmeti
Mbështetur nga	Komuna e Gjilanit / Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Vendi dhe viti	Gjilan, 2026

MIRËNJOHJE

Mbështetja institucionale

Ky manual është mbështetur nga Komuna e Gjilanit / Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Përmbajtja është përgatitur nga autorët dhe synon të shërbejë si burim praktik për mësimdhënësit, edukatorët dhe profesionistët që punojnë me fëmijët.

KONTAKTI I ORGANIZATËS

Adresa	**Rr. Haki Mynderrizi, Nr. 26, 60000 Gjilan, Kosovë**
Telefoni	+383 49 355 400
Email	info@inkluzioni.org
Rrjetet sociale	Facebook: Inkluzioni • Instagram: @inkluzioni_ • LinkedIn: Inkluzioni

© 2026 INKLUZIONI. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

PARATHËNIE

Me kënaqësi të veçantë ju prezantoj këtë manual praktik, të hartuar si një mbështetje e drejtpërdrejtë për mësimdhënësit, edukatorët dhe profesionistët që çdo ditë krijojnë mundësi të reja për zhvillimin dhe përfshirjen e fëmijëve. Komunikimi është më shumë se të folurit: ai është mënyra përmes së cilës fëmija shpreh nevojat, ndërton marrëdhënie, mëson dhe bëhet pjesë aktive e komunitetit të tij.

Si themeluese e Programit të Shërbimeve Logopedike në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Gjilanit, kam pasur mundësinë të shoh nga afër se sa shumë mund të ndryshojë rrugëtimi i një fëmije kur vështirësitë dallohen herët dhe mbështetja ofrohet në mjedisin ku ai mëson e ndërvepron çdo ditë. Prania e shërbimeve logopedike pranë institucioneve arsimore e afron ndihmën me fëmijën, e bën bashkëpunimin më të natyrshëm dhe krijon ura të qëndrueshme ndërmjet familjes, edukatorit dhe profesionistit.

Edhe themelimi i Qendrës Burimore "Ana" lindi nga e njëjta bindje: se çdo fëmijë duhet të ketë qasje në mbështetje të hershme, profesionale dhe të përshtatur sipas nevojave të tij. Përvoja e punës me fëmijë, prindër dhe institucione ka dëshmuar se rezultatet më të mira arrihen kur përgjegjësia ndahet, kur vëzhgimet komunikohen me respekt dhe kur ndërhyrja ndërtohet mbi pikat e forta të fëmijës.

Ky manual synon ta kthejë njohurinë profesionale në hapa të kuptueshëm dhe të zbatueshëm në klasë. Ai ofron pika orientuese për zhvillimin gjuhësor, përshkrime të vështirësive më të shpeshta, strategji mbështetëse, aktivitete dhe mjete praktike për vëzhgim e referim. Manuali nuk e zëvendëson vlerësimin profesional dhe nuk ka për qëllim vendosjen e diagnozave; ai ndihmon që shqetësimet të dallohen, të dokumentohen dhe të adresohen me kohë.

Mirënjohje e veçantë i takon Komunës së Gjilanit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për mbështetjen e këtij botimi. Gjithashtu, falenderojmë edhe Drejtorinë Komunale të Arsimit për bashkëpunimin e vazhdueshëm në realizimin e shërbimeve në institucionet edukativo-arsimore. Shpresoj që ky manual të shërbejë si një mjet pune i dobishëm dhe si një ftesë për bashkëpunim, në mënyrë që çdo fëmijë të ndihet i kuptuar, i përfshirë dhe i mbështetur për të komunikuar me besim.

Ardiana Bytyci

Themeluese e Programit të Shërbimeve Logopedike në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Gjilanit
Themeluese e Qendrës Burimore "Ana"

SI TA PËRDORNI KËTË MANUAL

Manuali mund të lexohet në tërësi ose të përdoret sipas nevojës: për vëzhgim, mbështetje në klasë, komunikim me prindërit dhe referim.

01	02	03	04
Vëzhgo	**Mbështet**	**Bashkëpuno**	**Refero**
Krahaso sjelljen e fëmijës me etapat orientuese të zhvillimit.	**Zbato strategjitë e klasës dhe dokumento përgjigjen e fëmijës.**	**Ndaj vëzhgime konkrete me familjen dhe ekipin profesional.**	**Kur shenjat vazhdojnë, përdor formularin dhe kërko vlerësim.**

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	**6. Aktivitetet praktike 0–6 vjeç**
2. Zhvillimi gjuhësor 0–6 vjeç	7. Bashkëpunimi me prindërit
3. Vështirësitë më të shpeshta të komunikimit	8. Raste studimore
4. Referimi dhe formulari praktik	9. Pyetje të shpeshta
5. Strategjitë mbështetëse në klasë	10. Referencat

KUJDES

Kufijtë profesionalë

Ky manual ndihmon në vëzhgim dhe mbështetje pedagogjike. Mësimdhënësi ose edukatori nuk vendos diagnozë; diagnoza dhe plani terapeutik përcaktohen nga profesionistët përkatës.

1. Hyrje

PSE KOMUNIKIMI I HERSHËM KA RËNDËSI



Punë individuale logopedike në ambientin e INKLUZIONI-t.

Logopedia studion çrregullimet e komunikimit: të folurit, gjuhën, zërin, rrjedhshmërinë, vështirësitë në të ushqyer dhe në gëlltitje. Për edukatorët, logopedia nuk fillon në kabinetin e terapisë, por aty ku fëmija kalon pjesën më të madhe të ditës: në shtëpi dhe në kopsht.

Ndërhyrja logopedike para moshës 6 vjeçare ndihmon në formimin e rrugëve të reja nervore. Sipas literaturës, truri i fëmijës në këto vite ka plasticitet të lartë (Shonkoff et al., 2012). Vonesat e pakapura në komunikim ndikojnë më vonë tek të nxënit e leximit dhe shkrimit, tek marrëdhëniet me moshatarët dhe tek rregullimi i emocioneve (Law et al., 2017).

Komunikimi në moshë të hershme përfshin më tepër se shqiptimi i tingujve. Ai nënkupton të kuptuarit e udhëzimeve, përdorimin e gjesteve, aftësinë për të filluar një bisedë, për të treguar nevojat dhe për të ndjekur rregullat sociale gjatë lojës. Kur një fëmijë 2-3 vjeç nuk tregon me gisht, ose në moshën 5-6 vjeç nuk tregon një histori të thjeshtë, këto konsiderohen shenja paralajmëruese (American Speech-Language-Hearing Association, 2020).

Periudha 0-6 vjeç është vendimtare për shkak të plasticitetit neuronal. Një vonesë e lehtë gjuhësore e kapur në moshën 3 vjeçare ka më shumë gjasa të korrigjohet me ndërhyrje të fokusuar, ndërsa e njëjta vonesë e patrajtuar deri në moshën 7-8 vjeç shoqërohet shpesh me vështirësi në lexim, ulje të vetëbesimit dhe diagnoza të tjera (Bishop et al., 2016; Snowling & Hulme, 2012).

Roli i edukatorit në ekipin logopedik është ai i vëzhguesit dhe referuesit të parë. Edukatori nuk diagnostikon, por dokumenton se si komunikon fëmija në grup, nëse luan me të tjerët, nëse tregon emrat e shokëve. Këto të dhëna janë të nevojshme për logopedin gjatë vlerësimit. Pa to, shumë fëmijë vlerësohen vonë dhe në kontekst jo natyral. Me to, vlerësimi mund të bëhet herët, kur plasticiteti i trurit është më i lartë.

2. Zhvillimi gjuhësor 0–6 vjeç

ETAPA ORIENTUESE DHE SHENJA QË KËRKOJNË VËMENDJE



Të nxënit përmes lojës dhe materialeve konkrete.

SHËNIM

Pikat e zhvillimit janë orientuese

Fëmijët zhvillohen me ritme të ndryshme. Shenjat e listuara duhen parë në kontekst dhe në disa situata, jo si test i vetëm diagnostikues (ASHA, 2020).

Para se të flasim për problemet, duhet ta kemi të qartë se çfarë është zhvillimi tipik. Fëmijët nuk zhvillohen të gjithë njësoj, por ka disa pikë referimi që na ndihmojnë të kuptojmë nëse jemi në rrugë të mbarë. Më poshtë mund të gjeni atë që konsiderohet tipike për secilën moshë. Këto nuk janë rregulla të ngurta – një fëmijë mund të jetë pak prapa në një fushë dhe shumë përpara në një tjetër. Por kur diferencat janë të mëdha, duhet të kemi kujdes.

0–6 muaj

Në gjashtë muajt e parë të jetës, foshnja fillon të kuptojë se tingujt kanë kuptim dhe reagojnë ndaj tyre. Ajo kthen kokën drejt zërave të njohur dhe qetësohet kur i flitet me zë të butë. Përveç të qarit për të shprehur nevojat, foshnja fillon të prodhojë edhe tinguj të thjeshtë si "gu" dhe "ga", të njohura si gugatje, të cilat përbëjnë hapat e parë drejt zhvillimit të të folurit. Në këtë fazë, është e rëndësishme të vëzhgohet reagimi ndaj tingujve: mungesa e reagimit ndaj zhurmave të forta, si zilja apo përplasja e derës, ose mosqetësimi nga zëri i kujdestarit, përfshirë atë të nënës, mund të jenë tregues të hershëm që kërkojnë vlerësim të mëtejshëm profesional.

6–12 muaj

Në këtë fazë fillon një periudhë shumë e rëndësishme e zhvillimit të komunikimit. Foshnja nis të kuptojë fjalë të thjeshta si "jo" apo "mirupafshim" dhe mund t'u përgjigjet thirrjeve të njohura, si "hajde te mami". Paralelisht shfaqen edhe gjestet komunikative, si tregimi me gisht apo tundja e kokës për të shprehur pohim ose mohim. Këto gjeste kanë një rol thelbësor, pasi tregojnë se aftësitë e komunikimit janë duke u ndërtuar edhe para shfaqjes së fjalëve të para. Gjithashtu, foshnja fillon të prodhojë tinguj të përsëritur si "mamama", "bababa" apo "dadada", të njohura si belbëzim (gugatje), të cilat përbëjnë ushtrimet e para drejt të folurit me kuptim.

Megjithatë, disa shenja mund të kërkojnë vëmendje të shtuar: nëse rreth moshës 10–12 muaj foshnja nuk përdor asnjë gjest komunikues (si tregimi apo tundja e kokës), ose nuk prodhon tinguj me bashkëtingëllore, kjo mund të jetë një tregues për nevojën e një vlerësimi të mëtejshëm profesional.

12–18 muaj

Në këtë periudhë shfaqen fjalët e para me kuptim të plotë. Fëmija fillon të kuptojë udhëzime të thjeshta, megjithëse shpesh ende ka nevojë për mbështetje me gjeste për t'i interpretuar ato saktë. Për shembull, nëse i kërkohet "ma jep topin" pa shoqërim me gjest, mund të mos e kuptojë plotësisht. Ai gjithashtu arrin të tregojë objekte të njohura kur i kërkohen.

Fjalori i shprehjes zakonisht përfshin rreth 5–20 fjalë të thjeshta, si "mami", "baba", "ujë", "top", "pi" apo "ha". Shqiptimi nuk është ende i saktë dhe fjalët mund të artikulohen në forma të thjeshtuara, por thelbësore është që ato të përdoren në mënyrë të qëndrueshme dhe me qëllim komunikimi. Nëse deri në moshën 15 muaj fëmija nuk ka zhvilluar ende asnjë fjalë me kuptim, rekomandohet të diskutohet kjo me prindërit dhe, nëse është e nevojshme, të merret në konsideratë një vlerësim i mëtejshëm profesional.

18–24 muaj

Në këtë fazë, fëmija zhvillon më tej të kuptuarit e gjuhës dhe fillon të përgjigjet ndaj pyetjeve të thjeshta, si "ku është këpuca?", si dhe të tregojë pjesë të trupit kur i kërkohen. Ai nuk ka më nevojë të vazhdueshme për mbështetje me gjeste, pasi është në gjendje të kuptojë dhe të zbatojë udhëzime verbale si "më sjell librin".

Fjalori pëson një rritje të shpejtë, duke kaluar nga rreth 50 fjalë në moshën 18 muaj në afërsisht 200 fjalë në moshën 24 muaj. Një arritje kyçe në këtë periudhë është fillimi i kombinimit të fjalëve në struktura të thjeshta dyfjalëshe, si "mami pi", "baba iki" apo "topi im". Edhe pse gramatika nuk është ende e zhvilluar plotësisht, këto kombinime tregojnë një hap të rëndësishëm drejt organizimit të mendimit dhe komunikimit.

Megjithatë, disa tregues kërkojnë vëmendje: nëse në moshën 20 muaj fëmija përdor më pak se 20 fjalë, ose nëse deri në 24 muaj nuk ka filluar ende të përdorë kombinime dyfjalëshe, rekomandohet vlerësim i mëtejshëm për zhvillimin e gjuhës dhe komunikimit.

2–3 vjeç

Në këtë fazë, zhvillimi gjuhësor dhe njohës bëhet më i avancuar dhe më i strukturuar. Fëmija fillon të kuptojë koncepte më komplekse, si dallimi ndërmjet njëjësit dhe shumësit, si dhe është në gjendje të ndjekë dy udhëzime të njëpasnjëshme, p.sh. "merr lugën dhe jepja mamit". Ai arrin të dallojë forma dhe ngjyra bazë, edhe nëse nuk është ende në gjendje t'i emërtojë ato saktë.

Fjalori aktiv zgjerohet ndjeshëm, duke arritur rreth 300–500 fjalë, ndërsa fjalitë bëhen më të gjata dhe më të strukturuara, zakonisht me 3–4 fjalë. Fëmija fillon të bëjë pyetje të thjeshta, shpesh duke përdorur forma si "çfarë është kjo?", çka tregon rritje të kuriozitetit dhe të aftësive komunikuese.

Sa i përket kuptueshmërisë së të folurit, një rregull orientues është se në moshën 2 vjeç një i huaj kupton rreth gjysmën e asaj që thotë fëmija, ndërsa në moshën 3 vjeç rreth tre të katërtat.

Megjithatë, disa tregues mund të sinjalizojnë nevojën për vëmendje të shtuar: nëse në moshën 3 vjeç fëmija nuk është fare i kuptueshëm për persona të panjohur, nëse nuk përdor ende përemra (p.sh. përdor "mami do" në vend të "unë dua"), ose nëse nuk arrin të kombinojë fjalët në fjali të thjeshta, rekomandohet një vlerësim i mëtejshëm profesional për zhvillimin e gjuhës.

3–4 vjeç

Në këtë moshë, fëmija zhvillon më tej të kuptuarit e koncepteve hapësinore si "sipër–poshtë" dhe "brenda–jashtë". Ai është në gjendje të ndjekë deri në tre udhëzime të njëpasnjëshme, nëse ato janë të thjeshta dhe të qarta. Fjalori zgjerohet ndjeshëm, duke arritur mbi 800–1000 fjalë. Një arritje e rëndësishme është aftësia për të treguar ngjarje të shkurtra, p.sh. "shkova në park dhe rashë". Këto përbëjnë format e para të rrëfimit, të cilat shpesh ndërthuren me elemente imagjinare, gjë që konsiderohet plotësisht normale në këtë fazë.

Një fenomen i zakonshëm që shpesh shqetëson prindërit është belbëzimi kalimtar, i cili mund të shfaqet midis moshës 2.5 dhe 3.5 vjeç. Fëmija mund të përsërisë rrokje ose fjalë, veçanërisht kur është i emocionuar. Në shumicën e rasteve, kjo është një fazë zhvillimore kalimtare dhe zgjidhet spontanisht.

Megjithatë, disa tregues kërkojnë vëmendje: nëse fjalitë mbeten të fragmentuara dhe nuk strukturohen ("top... unë... jo"), nëse fëmija nuk arrin të tregojë as ngjarje të thjeshta, ose nëse belbëzimi zgjat më shumë se 6 muaj dhe shoqërohet me tendosje të dukshme të muskujve të fytyrës gjatë të folurit, rekomandohet vlerësim profesional.

4–5 vjeç

Në këtë periudhë, fëmija fillon të kuptojë konceptet kohore si "sot", "nesër" dhe "dje", edhe pse mund t'i ngatërrojë ende. Ai arrin të kuptojë shaka të thjeshta dhe zhvillon më tej aftësitë e komunikimit social. Fjalori aktiv tejkalon 1500 fjalë.

Sa i përket shqiptimit, shumica e tingujve duhet të jenë tashmë të konsoliduar. Megjithatë, tinguj si "rr", "zh" dhe "xh" zakonisht përvetësohen më vonë, ndërsa "r", "z" dhe "s" mund të paraqesin ende vështirësi. Në këtë moshë, një fëmijë duhet të jetë i kuptueshëm për të huajt në rreth 90–100% të rasteve.

Shenja që kërkojnë vëmendje përfshijnë zëvendësimin sistematik të tingujve pas moshës 4.5 vjeç (p.sh. "toka" në vend të "soka", "papa" në vend të "baba"), si dhe vështirësinë për të treguar një histori të njohur edhe me ndihmë.

5–6 vjeç

5–6 vjeç Kjo është periudha përgatitore për shkollë, ku aftësitë gjuhësore dhe komunikuese bëhen më të avancuara. Fëmija kupton dhe përdor shaka të thjeshta dhe gjëegjëza, si dhe zotëron konceptet bazë numerike (1–10) dhe rendore ("i pari", "i fundit"). Të folurit bëhet i rrjedhshëm dhe pa ndërprerje të theksuara.

Fëmija përdor fjali të përbëra me lidhëza si "por", "sepse" dhe "dhe pastaj", duke ndërtuar rrëfime të kuptueshme për bashkëbiseduesin. Deri në këtë moshë, pritet që të jenë përvetësuar të gjithë tingujt e shqipes, përfshirë "rr", "zh", "xh" dhe "r".

Nëse një fëmijë 5.5–6 vjeç nuk arrin të shqiptojë disa tinguj (p.sh. "s", "z", "c", "r", "rr"), ose nëse ka vështirësi në komunikim funksional — si mungesa e pjesëmarrjes në bisedë, mosbërja e pyetjeve apo përgjigje jo të përshtatshme — rekomandohet një vlerësim i specializuar.

PRAKTIKË

Këshillë për edukatorët

Këto udhëzime shërbejnë si pika orientuese për vëzhgim dhe jo si mjete diagnostikuese. Nëse një fëmijë nuk i përmbush disa nga këto etapa, është e rëndësishme të mos nxirren përfundime të menjëhershme. Rekomandohet të dokumentohen vëzhgimet në mënyrë të rregullt dhe të diskutohet me prindërit dhe specialistët përkatës, si logopedi. Identifikimi i hershëm i vështirësive në zhvillim e bën ndërhyrjen më efektive dhe mbështet progresin optimal të fëmijës.

3. Vështirësitë më të shpeshta të komunikimit

PËRSHKRIME TË PLOTA DHE TABELË ORIENTUESE

ORIENTIM

Lexoni përshkrimet para tabelës

Çdo vështirësi paraqitet fillimisht me përshkrimin e plotë. Tabela përmbledhëse gjendet në fund të këtij kapitulli për konsultim të shpejtë.

1. Vonesa e thjeshtë e të folurit

Kjo karakterizohet nga një zhvillim normal i të kuptuarit të gjuhës, ndërsa prodhimi i të folurit është i vonuar. Fëmija mund të kuptojë udhëzime dhe komunikim të përditshëm, por përdor një numër të kufizuar fjalësh për moshën e tij. Për shembull, një fëmijë 3 vjeç mund të kuptojë mirë, por të shprehë vetëm rreth 10 fjalë. Në rast se nuk vërehet përmirësim brenda një periudhe prej rreth 6 muajsh, rekomandohet referimi për vlerësim specialistik.

2. Çrregullimi i artikulimit

Ky çrregullim lidhet me vështirësi në prodhimin e saktë të tingujve të të folurit, në përputhje me moshën e fëmijës. Zhvillimi i tingujve ndjek një rend tipik: deri në moshën 3 vjeç priten tingujt bazë (p, b, m, n, t, d); rreth 4 vjeç shtohen k, g, f, v, l, j; në 5 vjeç zhvillohen tinguj më kompleksë si c, ç, s, z, sh, zh; ndërsa deri në 6 vjeç përvetësohen tingujt më të vështirë si "rr" dhe "xh" (me disa variacione individuale për "r" dhe "x"). Vështirësitë përtej këtyre kufijve kërkojnë vlerësim.

3. Apraksia e të folurit në fëmijëri (CAS)

Ky është një çrregullim neurologjik që ndikon në planifikimin dhe koordinimin e lëvizjeve të nevojshme për të folur. Një shenjë karakteristike është paqëndrueshmëria në prodhimin e fjalëve: fëmija mund të shqiptojë një fjalë saktë në një moment dhe ta ketë të pamundur ta përsërisë më pas. Për shembull, mund të thotë "mami" në mëngjes dhe më vonë "mimi". Ky çrregullim kërkon ndërhyrje të specializuar dhe referim të menjëhershëm.

4. Disfluenca (belbëzimi)

Disfluenca përfshin ndërprerje në rrjedhshmërinë e të folurit dhe mund të paraqitet në forma të ndryshme: tonike (bllokime të zërit), klonike (përsëritje të tingujve) ose të kombinuara. Një fazë kalimtare e disfluencës është e zakonshme midis moshës 2–4 vjeç dhe zakonisht zgjat deri në 3 muaj. Nëse vazhdon më gjatë ose shfaqet pas moshës 5 vjeç, rekomandohet vlerësim profesional.

5. Çrregullimi i të kuptuarit gjuhësor (receptiv)

Në këtë rast, fëmija mund të ketë të folur të pranishëm, por ka vështirësi në të kuptuarit e gjuhës. Ai mund të mos ndjekë udhëzime të thjeshta ose të mos përgjigjet saktë ndaj kërkesave. Për shembull, kur i kërkohet "merr luanin e kuq", mund të zgjedhë një objekt të rastësishëm. Kjo kërkon vlerësim të kujdesshëm të aftësive receptive.

6. Mutizmi selektiv

Ky çrregullim karakterizohet nga aftësia për të folur në ambiente të caktuara (p.sh. në shtëpi), ndërsa në mjedise të tjera si kopshti apo shkolla fëmija nuk flet fare. Zakonisht vihet re pas moshës 3 vjeç. Është e rëndësishme që fëmija të mos detyrohet të flasë, por të mbështetet përmes një qasjeje të integruar psikologjike dhe logopedike.

7. Çrregullimi i pragmatikës (përdorimi social i gjuhës)

Ky çrregullim lidhet me vështirësi në përdorimin e gjuhës në kontekst social. Fëmija mund të ketë vështirësi në marrjen e radhës në bisedë, mund të flasë gjatë për një temë pa ndërveprim reciprok, ose të mos kuptojë shakatë dhe nënkuptimet. Shpesh këto vështirësi shfaqen tek fëmijët në spektrin e autizmit dhe kërkojnë vlerësim të specializuar.

8. Shenja të hershme të disleksisë (5–6 vjeç)

Në moshën parashkollore mund të shfaqen tregues të hershëm të vështirësive në lexim. Këto përfshijnë vështirësi në identifikimin e rimave, ndarjen e fjalëve në rrokje dhe mbajtjen mend të emrave të shkronjave. Në këto raste rekomandohet ndërhyrje e hershme përmes logopedisë dhe mbështetjes në fushën e të nxënit.

9. Çrregullimi fonologjik

Ky çrregullim karakterizohet nga përdorimi sistematik i rregullave të pasakta në organizimin e tingujve. Fëmija mund të zëvendësojë vazhdimisht një tingull me një tjetër, p.sh. të përdorë "l" në vend të "r" në të gjitha fjalët ("rroba" → "lloba", "prit" → "plit"). Ky model i qëndrueshëm kërkon ndërhyrje logopedike.

10. Vonesa dytësore nga dëmtimi i dëgjimit

Vështirësitë në dëgjim mund të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e të folurit dhe gjuhës. Shenjat përfshijnë mungesën e reagimit ndaj thirrjeve (sidomos kur vjen nga pas) dhe përdorimin e një zëri shumë të lartë ose shumë të ulët. Në këto raste, hapi i parë është vlerësimi nga mjeku otorinolaringolog, përpara fillimit të terapisë logopedike.

Tabela përmbledhëse e vështirësive të komunikimit

Tabela përdoret për orientim të shpejtë pasi të jenë lexuar përshkrimet e plota më sipër; ajo nuk zëvendëson vlerësimin profesional.

Vështirësia	Shenja kryesore	Mbështetja në klasë	Kur të referohet
Vonesa e të folurit	Pak fjalë për moshën; kuptimi mund të jetë më i mirë se shprehja.	Modelo fjali të shkurtra; dokumento fjalorin.	Nëse progresi mungon ose ka shqetësime të tjera.
Çrregullimi i artikulimit	Tinguj të pasaktë ose të munguar përtej moshës së pritshme.	Mos e turpëro; jep modelin e saktë natyrshëm.	Kur kuptueshmëria ose pjesëmarrja preket.
Apraksia e të folurit	Gabime të paqëndrueshme; vështirësi në renditjen e tingujve.	Jep kohë, alternativa vizuale dhe fjali të shkurtra.	Referim i menjëhershëm te logopedi.
Belbëzimi	Përsëritje, zgjatje ose bllokime; mund të ketë tendosje.	Dëgjo pa e ndërprerë; ul ritmin e bisedës.	Kur zgjat, rritet ose shoqërohet me tension.
Vështirësia receptive	Nuk ndjek udhëzime ose zgjedh përgjigje të rastësishme.	Përdor fjali të shkurtra, figura dhe demonstrim.	Kur vështirësia është e qëndrueshme në rutina.
Mutizmi selektiv	Flet në disa mjedise, por jo në klasë ose kopsht.	Mos e detyro; prano përgjigje joverbale dhe ndërto siguri.	Vlerësim i integruar psikologjik dhe logopedik.
Pragmatika sociale	Vështirësi me radhën, temën, nënkuptimet dhe përshtatjen sociale.	Strukturo radhën; përdor role dhe skenarë socialë.	Kur pengon marrëdhëniet dhe pjesëmarrjen.
Shenja të disleksisë	Vështirësi me rimat, rrokjet dhe emrat e shkronjave.	Lojëra fonologjike të shkurtra e të shpeshta.	Për vlerësim të hershëm para dhe gjatë fillimit të shkollës.
Çrregullimi fonologjik	Modele sistematike zëvendësimi të tingujve.	Modelim pa korrigjim të ashpër; lojëra me tinguj.	Kur modeli vazhdon dhe ul kuptueshmërinë.
Vonesa nga dëgjimi	Nuk reagon ndaj thirrjeve; ndryshon volumin e zërit.	Ulu përballë, redukto zhurmën dhe përdor pamje.	Së pari kontroll i dëgjimit / ORL, pastaj logopedi.

4. Referimi

NGA VËZHGIMI TE BASHKËPUNIMI PROFESIONAL

Referimi i një fëmije për vlerësim logopedik është një proces i rëndësishëm që duhet të bazohet në vëzhgim të kujdesshëm, dokumentim të qartë dhe bashkëpunim të ngushtë me prindërit dhe profesionistët përkatës. Ky proces nuk synon vendosjen e një diagnoze nga ana e mësimdhënësit, por identifikimin e hershëm të vështirësive të mundshme në komunikim, gjuhë dhe të folur, në mënyrë që fëmija të marrë mbështetjen e duhur në kohën e duhur.

Hapi i parë përfshin një periudhë vëzhgimi të strukturuar prej 1–2 javësh në mjedisin natyror të fëmijës (klasë apo kopsht). Gjatë kësaj kohe, mësimdhënësi duhet të dokumentojë elemente konkrete të komunikimit, si numri i fjalëve që fëmija përdor brenda një intervali të caktuar (p.sh. gjatë 30 minutave), përdorimi i gjesteve për të shprehur nevojat ose për të plotësuar të folurin, si dhe mënyra se si fëmija reagon kur nuk kuptohet nga të tjerët (p.sh. përsërit, heq dorë, apo përdor forma alternative komunikimi). Ky dokumentim është thelbësor për të krijuar një pasqyrë të qartë të funksionimit komunikativ të fëmijës.

Hapi i dytë lidhet me përjashtimin e faktorëve biologjikë, veçanërisht dëgjimit. Vështirësitë në të dëgjuar mund të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e gjuhës dhe të folurit, prandaj është e rëndësishme që prindi të inkurajohet të kryejë një test audiometrik tek një specialist i fushës, si otorinolaringolog.

Hapi i tretë përfshin komunikimin profesional dhe empatik me prindërit. Diskutimi duhet të bazohet në vëzhgime konkrete dhe jo në supozime, duke shmangur gjuhën alarmuese. Qëllimi është informimi dhe ndërgjegjësimi i prindit për zhvillimin e fëmijës, si dhe krijimi i një bashkëpunimi të hapur për hapat e mëtejshëm.

Më pas, rekomandohet plotësimi i formularit të referimit, duke përfshirë të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë vëzhgimit dhe çdo informacion shtesë relevant për zhvillimin e fëmijës. Ky dokument shërben si bazë për specialistët që do të kryejnë vlerësimin e mëtejshëm.

Sa i përket orientimit të referimit, ekzistojnë disa mundësi në varësi të kontekstit dhe burimeve në dispozicion. Fëmija mund të drejtohet fillimisht në një qendër shëndetësore tek pediatri, i cili më pas e referon tek logopedi në shërbimin

publik. Alternativisht, prindërit mund të zgjedhin shërbime logopedike private, nëse kanë mundësi. Një tjetër opsion janë qendrat e zhvillimit pranë njësive vendore, të cilat shpesh ofrojnë shërbime multidisiplinare për vlerësim dhe ndërhyrje të hershme.

Në të gjitha rastet, theksi duhet të vendoset tek ndërhyrja e hershme dhe e koordinuar. Sa më herët të identifikohet dhe të adresohet një vështirësi në komunikim apo gjuhë, aq më të mëdha janë mundësitë për përmirësim dhe përfshirje të suksesshme të fëmijës në procesin mësimor dhe social. Ky proces kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet mësimdhënësve, prindërve dhe specialistëve, duke vendosur gjithmonë në qendër nevojat dhe mirëqenien e fëmijës.

FORMULAR PËR REFERIM NË SHËRBIMIN E LOGOPEDISË

FORMULAR PRAKTIK
Si të plotësohet formulari
Përdorni shembuj të vëzhgueshëm, shënoni datat dhe shmangni etiketimet diagnostikuese.

TË DHËNAT E FËMIJËS

Emri dhe mbiemri: _____

Mosha: _____ vjeç _____ muaj

Klasa/Grupi: _____

TË DHËNAT E REFERUESIT

Emri i mësimdhënësit/edukatorit: _____

Data e referimit: ____ / ____ / _____

ARSYEJA E REFERIMIT

Ju lutem shënoni (✓) vështirësitë e vërejtura:

- ☐ Flet më pak se moshatarët (zhvillim i vonuar i të folurit)
- ☐ Shqiptim i pasaktë i tingujve (specifikoni: _____)
- ☐ Vështirësi në rrjedhshmëri (belbëzim)
- ☐ Vështirësi në të kuptuarit e udhëzimeve
- ☐ Vështirësi në shprehjen verbale (ndërtimi i fjalive, fjalori)
- ☐ Vështirësi në komunikimin me të tjerët
- ☐ Tjetër: _____

PËRSHKRIM I SHKURTËR I VËSHTIRËSIVE

(Ju lutem jepni një ose dy shembuj konkretë)

_____

_____

HISTORIKU

Kur janë vërejtur për herë të parë këto vështirësi?

_____

_____

Sa shpesh shfaqen këto vështirësi? ☐ Gjithmonë ☐ Shpesh ☐ Ndonjëherë

NDËRHYRJET E DERITANISHME

Çfarë keni provuar deri tani në klasë?

_____

_____

INFORMIMI I PRINDIT

A është informuar prindi/kujdestari për këtë referim? ☐ Po ☐ Jo

NËNSHKRIMET

Nënshkrimi i mësimdhënësit: _____

Nënshkrimi i prindit/kujdestarit: _____

5. Strategjitë mbështetëse në klasë

NDËRHYRJE TË VOGLA ME NDIKIM TË PËRDITSHËM



Aktivitet praktik me figura dhe modele konkrete për zhvillimin e gjuhës.

Qëllimi i materialit

Ky material ofron strategji praktike për mbështetjen e fëmijëve me vështirësi në të folur dhe komunikim në mjedisin e klasës. Strategjitë janë të thjeshta për t'u zbatuar dhe synojnë përmirësimin e të kuptuarit, të shprehurit dhe përfshirjes aktive të fëmijës.

A. Strategji për gjuhën receptive (të kuptuarin)

Nr.	Strategjia	Shembull praktik
1	Përdorni udhëzime të shkurtra dhe të qarta (3–5 fjalë)	"Vendose lugën" në vend të një fjalie të gjatë
2	Përsëritni udhëzimet kur është e nevojshme	"Ngri duart... ngri duart lart"
3	Përdorni mbështetje vizuale (figura, objekte)	Tregoni figurën e gotës ndërsa thoni "gota"
4	Ndani udhëzimet në hapa të vegjël	"Së pari merr librin. Pastaj hape."
5	Verifikoni të kuptuarin në mënyrë aktive	"Më trego çfarë duhet të bësh"

B. Strategji për gjuhën ekspresive (të folurit shprehës)

Nr.	Strategjia	Shembull praktik
6	Modelimi i zgjeruar i të folurit	Fëmija: "makinë" → "Po, makina e madhe po lëviz"
7	Përdorni vetë-dialogun gjatë aktiviteteve	"Po hap rubinetin... po marr sapunin"
8	Përdorni dialog paralel	"Ti po vendos kubin e kuq mbi kubin blu"
9	Krijoni rutina të parashikueshme komunikimi	"Mirëmëngjes, si je sot?"
10	Përdorni libra me figura dhe pyetje të thjeshta	"Çfarë sheh?"

C. Strategji për mbështetjen emocionale dhe vetëvlerësimin

Nr.	Strategjia
11	Lavdëroni përpjekjen, jo vetëm saktësinë (p.sh. "Bravo që u përpoqe!")
12	Shmangni korrigjimin e drejtpërdrejtë; modeloni formën e saktë të fjalës
13	Jepini role ku fëmija mund të ketë sukses (p.sh. shpërndarja e materialeve)
14	Krijoni një hapësirë të qetë ku fëmija mund të tërhiqet nëse ndihet i mbingarkuar

D. Strategji për rrjedhshmërinë e të folurit (belbëzimin)

Nr.	Strategjia
15	Mos e ndërprisni fëmijën gjatë të folurit; jepini kohë të përfundojë
16	Flisni me ritëm të ngadaltë dhe me pauza natyrale
17	Shmangni udhëzimet direkte si "ngadalëso" apo "merr frymë"
18	Mbani kontakt të qetë me sy, pa ushtruar presion

E. Strategji për përfshirjen në grup

Nr.	Strategjia
19	Caktoni një bashkëmoshatar mbështetës për aktivitetet në klasë
20	Jepini role të thjeshta dhe të arritshme gjatë aktiviteteve në grup
21	Përdorni karta me figura për të ndihmuar komunikimin e nevojave bazë
22	Respektoni ritmin e fëmijës; mos e detyroni të flasë para grupit nëse nuk është gati

F. Strategji për bashkëpunimin me prindërit

Nr.	Strategjia
23	Sugjeroni lojëra të thjeshta në shtëpi (p.sh. “Unë shoh diçka…”, këngë me lëvizje)
24	Inkurajoni leximin e përditshëm (10 minuta) me fokus në figura dhe diskutim
25	Promovoni komunikimin ballë për ballë gjatë aktiviteteve të përditshme duke reduktuar përdorimin e ekraneve

6. Aktivitetet praktike 0–6 vjeç

LOJË, GJUHË DHE PJESËMARRJE



Aktivitet shqisor për zhvillimin e gjuhës dhe përqendrimit.

(Për përdorim në klasë dhe në mjedise edukative)

1. Dëgjo dhe vepro

Mosha: 2–6 vjeç Qëllimi: Zhvillimi i të kuptuarit të udhëzimeve Si realizohet: Filloni me udhëzime të thjeshta (1 hap), pastaj rritni në 2–3 hapa.

Shembull: "Prek hundën", "Duart lart dhe kërce".

2. Ku është? (lojë me fshehje)

Mosha: 1.5–5 vjeç Qëllimi: Zhvillimi i koncepteve hapësinore dhe kuptimit Si realizohet: Fshihni një lodër dhe jepni udhëzime të thjeshta.

Shembull: "Poshtë tavolinës", "Brenda kutisë".

3. Lojë me emërtime (Çfarë është kjo?)

Mosha: 1–4 vjeç Qëllimi: Zhvillimi i fjalorit Si realizohet: Tregoni objekte ose figura dhe emërtoni së bashku.

Shembull: "Top", "Makina", "Mace".

4. Këngë me lëvizje

Mosha: 1–5 vjeç Qëllimi: Zhvillimi i ritmit, imitimit dhe fjalorit Si realizohet: Këndoni këngë të thjeshta me lëvizje trupore.

Shembull: "Koka, supet, gjunjët, gishtat".

5. Kubi i tregimit (version i thjeshtuar)

Mosha: 3–6 vjeç Qëllimi: Nxitja e të folurit shprehës Si realizohet: Fëmija hedh kubin dhe thotë një fjalë ose fjali të shkurtër sipas figurës.

6. Përfundo fjalinë

Mosha: 3–6 vjeç Qëllimi: Zhvillimi i strukturës së fjalisë Si realizohet: Filloni fjali të thjeshta që fëmija t'i plotësojë.

Shembull: "Unë ha..." → "bukë"

7. Thesari i tingujve

Mosha: 3–6 vjeç Qëllimi: Vetëdijësim fonologjik Si realizohet: Vendosni objekte me të njëjtin tingull në një qese dhe fëmija i emërton.

8. Gjuetia e objekteve

Mosha: 2–6 vjeç Qëllimi: Zhvillimi i fjalorit dhe kuptimit Si realizohet: Kërkoni nga fëmija të gjejë objekte sipas një kategorie.

Shembull: "Gjej diçka të kuqe", "Gjej diçka për të ngrënë".

9. Loja me kukulla (dialog i thjeshtë)

Mosha: 2–6 vjeç Qëllimi: Nxitja e komunikimit social Si realizohet: Përdorni kukulla për të krijuar dialog të thjeshtë.

10. Turni i bisedës

Mosha: 3–6 vjeç Qëllimi: Mësimi i radhës në komunikim Si realizohet: Përdorni një objekt që tregon kush flet.

11. Si ndihet? (emocionet)

Mosha: 2–6 vjeç Qëllimi: Zhvillimi emocional dhe gjuhësor Si realizohet: Tregoni figura dhe emërtoni emocionet.

12. Loja me role (shtëpia, dyqani)

Mosha: 3–6 vjeç Qëllimi: Zhvillimi i komunikimit funksional Si realizohet: Krijoni situata të përditshme dhe nxisni dialog.

13. Tavolina ndijore (sensore)

Mosha: 1–5 vjeç Qëllimi: Nxitja e gjuhës përmes përvojës shqisore Si realizohet: Përdorni rërë, oriz, ujë dhe përshkruani ndjesitë.

Shembull: "I butë", "I fortë", "I lagësht".

14. Frymëmarrja e qetë

Mosha: 3–6 vjeç Qëllimi: Relaksim dhe mbështetje për rrjedhshmëri Si realizohet: "Nuha lulen... fryje qirinë".

15. Libri me figura

Mosha: 1–6 vjeç Qëllimi: Zhvillimi i fjalorit dhe kuptimit Si realizohet: Shikoni figura dhe bëni pyetje të thjeshta.

Shembull: "Çfarë është kjo?", "Çfarë po bën?"

16. Përralla- Dëgjimi aktiv dhe zhvillimi i fjalorit përmes përrallës

Mosha: 4-6 vjeç

Qëllimi i aktivitetit: Ky aktivitet synon të zhvillojë aftësitë e dëgjimit me vëmendje, të kuptuarit e tekstit, si dhe pasurimin e fjalorit dhe aftësinë për të ndërtuar fjali tek fëmijët. Gjithashtu nxit shprehjen verbale dhe organizimin e mendimeve në mënyrë të strukturuar.

Përshkrimi i aktivitetit: Edukatori lexon një përrallë të përshtatshme për moshën e fëmijëve, duke u fokusuar në intonacion, ritëm dhe theksim të ngjarjeve kryesore për të nxitur dëgjim aktiv dhe vëmendje të qëndrueshme.

Pas leximit, fëmijët inkurajohen të rikujtojnë dhe të përshkruajnë me fjalët e tyre ngjarjet kryesore të përrallës. Fillimisht, ata mund të shprehen në mënyrë të thjeshtë me fjalë të veçanta ose fraza të shkurtra, ndërsa edukatori i mbështet duke i nxitur të zgjerojnë shprehjet e tyre në fjali më të plota.

Në vijim, në tabelë vizatohen ose paraqiten figurat kryesore të përrallës (personazhet dhe ngjarjet kryesore). Këto shërbejnë si mbështetje vizuale për të ndihmuar fëmijët të rikujtojnë rrjedhën e ngjarjeve dhe të strukturojnë më mirë tregimin.

Fëmijët nxiten të përshkruajnë secilën figurë, të lidhin ngjarjet mes tyre dhe të përdorin sa më shumë fjalë brenda fjalive të tyre, duke u përpjekur të rikrijojnë përrallën ashtu siç e kanë dëgjuar.

7. Bashkëpunimi me prindërit

NGA REZISTENCA TE BASHKËPUNIMI AKTIV



Shkëmbim profesional dhe bashkëpunim me komunitetin edukativ.

(Qasje praktike për mësimdhënës)

Qasja ndaj prindërve sipas reagimit emocional

1. Prindi në mohim e vështirësisë

Karakteristikat:

Minimizon vështirësinë

Thotë: "Edhe unë kam folur vonë dhe jam zhvilluar normalisht"

Qasja profesionale: Normalizoni situatën pa e kundërshtuar drejtpërdrejt.

Shembull komunikimi: "Është e vërtetë që disa fëmijë flasin më vonë. Megjithatë, logopedia ndihmon shumë fëmijë të zhvillojnë komunikimin më lehtë dhe më shpejt, ashtu si syzet ndihmojnë shikimin."

2. Prindi i shqetësuar / i frikësuar

Karakteristikat:

Ka frikë për diagnozë serioze

Pyet: "A është diçka e rëndë?"

Qasja profesionale: Qetësoni prindin dhe jepni informacion të balancuar.

Shembull komunikimi: "Në shumicën e rasteve bëhet fjalë për vështirësi të lehta në zhvillimin e gjuhës. Sa më herët të fillohet mbështetja, aq më të mira janë rezultatet."

3. Prindi me ndjenjë faji

Karakteristikat:

Merr përgjegjësi personale

Thotë: "Është faji im"

Qasja profesionale: Ulni ndjenjën e fajit dhe normalizoni situatën.

Shembull komunikimi: "Vështirësitë në të folur nuk lidhen me kujdesin apo dashurinë e prindit. Ato janë pjesë e zhvillimit dhe mund të përmirësohen me mbështetjen e duhur."

4. Prindi që kërkon zgjidhje të shpejtë

Karakteristikat:

Pret rezultate të menjëhershme

Pyet: "A mjafton një muaj terapi?"

Qasja profesionale: Vendosni pritshmëri realiste dhe transparente.

Shembull komunikimi: "Logopedia është një proces gradual. Kohëzgjatja varet nga nevojat e fëmijës, por zakonisht përmirësimet vihen re me një program disa mujor (rreth 6–12 muaj ose më shumë sipas rastit)."

NË PRAKTIKË

Momente nga loja, puna dhe bashkëpunimi



LOJA SI MJET KOMUNIKIMI

Aktivitet praktik dhe pjesëmarrje aktive



BASHKËPUNIM ME PRINDËRIT



MËSIM DHE SHKËMBIM PROFESIONAL

Çdo aktivitet është një mundësi

për të ndërtuar komunikim, besim dhe përfshirje.

8. Raste studimore

VËZHGIM, ARSYETIM DHE REKOMANDIM

Rasti 1: Erlindi, 3.5 vjeç

Situata klinike: Erlindi është fëmijë 3.5 vjeç i cili në mjedisin e kopshtit nuk përdor komunikim verbal me edukatorët apo bashkëmoshatarët. Ai shpesh mbetet i heshtur gjatë aktiviteteve grupore dhe nuk inicon komunikim spontan. Sipas prindërve, në shtëpi përdor një përzierje të shqipes dhe turqishtes, por me fjalor të kufizuar dhe kryesisht me fjalë të izoluara. Nuk raportohet përdorim i fjalive të plota.

Vëzhgim profesional: Në këtë moshë pritet që fëmija të ketë një fjalor të zhvilluar (rreth 200+ fjalë), të kombinojë fjalë dhe të komunikojë nevoja bazë në mënyrë funksionale. Mungesa e komunikimit në mjedisin e klasës dhe fjalori i kufizuar kërkojnë vlerësim të zhvillimit gjuhësor, duke marrë parasysh edhe faktorët bilingualë.

Rekomandim: Referim për vlerësim logopedik të plotë të gjuhës ekspresive dhe receptive, si dhe vlerësim të ndikimit të bilingualizmit në zhvillimin e komunikimit.

Rasti 2: Era, 5 vjeç

Situata klinike: Era është një fëmijë 5 vjeç me histori të belbëzimit që ka filluar rreth moshës 3 vjeç. Vështirësitë në rrjedhshmëri janë të vazhdueshme dhe përfshijnë përsëritje të tingujve, zgjatje të fjalëve dhe bllokime gjatë të folurit. Sipas raportimeve, prindërit nuk kanë kërkuar më parë ndihmë profesionale.

Vëzhgim profesional: Belbëzimi që zgjat më shumë se 12–18 muaj në moshën parashkollore konsiderohet faktor risku dhe kërkon ndërhyrje të hershme, sidomos kur është i vazhdueshëm dhe ndikon në komunikimin e përditshëm.

Rekomandim: Referim urgjent te logopedi i specializuar në çrregullimet e rrjedhshmërisë (fluency disorders) për vlerësim dhe fillim të ndërhyrjes terapeutike.

Rasti 3: Noemi, 4 vjeç

Situata klinike: Noemi është një fëmijë 4 vjeç me zhvillim të përgjithshëm të mirë të gjuhës, por me vështirësi në shqiptimin e disa tingujve specifikë (“sh”, “zh”, “ç”). Fjalitë janë të kuptueshme në përgjithësi, megjithëse disa fjalë përmbajnë zëvendësime të tingujve.

Vëzhgim profesional: Në moshën 4 vjeç, disa vështirësi fonologjike mund të jenë ende brenda kufijve të zhvillimit tipik, pasi disa tinguj komplekse përvetësohen më vonë. Megjithatë, kërkohet monitorim i vazhdueshëm për të parë nëse gabimet persistojnë ose ndikojnë në kuptueshmërinë e të folurit.

Rekomandim: Monitorim i zhvillimit të të folurit deri në moshën 4.5–5 vjeç. Nëse vështirësitë vazhdojnë, rekomandohet vlerësim logopedik për artikulim dhe fonologji.

Rasti 4: Arti, 2.5 vjeç

Situata klinike: Arti është një fëmijë 2.5 vjeç me fjalor shumë të kufizuar. Aktualisht përdor vetëm disa fjalë të izoluara si “mama” dhe “baba”. Nuk kombinon fjalë për të formuar shprehje dy-fjalëshe dhe komunikimi i tij është kryesisht joverbal (gjeste, tërheqje e dorës së të rriturit).

Vëzhgim profesional: Në këtë moshë pritet zhvillimi i fjalorit aktiv prej rreth 50 fjalësh dhe fillimi i kombinimit të fjalëve (p.sh. “dua ujë”, “mama hajde”). Mungesa e këtyre elementeve është tregues i vonesës në zhvillimin e gjuhës ekspresive.

Rekomandim: Referim i menjëhershëm për vlerësim logopedik të zhvillimit të gjuhës ekspresive dhe receptive.

Rasti 5: Sara, 5.5 vjeç

Situata klinike: Sara është një fëmijë 5.5 vjeç me vështirësi në kuptimin dhe përpunimin e gjuhës narrative. Ajo ka vështirësi në përgjigjen e pyetjeve që lidhen me renditjen kohore të ngjarjeve (“çfarë ndodhi më parë?”, “çfarë ndodhi më pas?”) dhe shpesh nuk arrin të ritregojë një histori në mënyrë të organizuar.

Vëzhgim profesional: Këto vështirësi mund të lidhen me aftësi të dobëta në gjuhën receptive dhe në strukturimin narrativ, të cilat janë të rëndësishme për përgatitjen shkollore dhe të nxënit akademik.

Rekomandim: Referim për vlerësim të gjuhës receptive dhe aftësive narrative (strukturimi i tregimit dhe kuptimi i sekuencës logjike).

Rasti 6: Altina, 5 vjeçe

Situata klinike: A. është një fëmijë 5 vjeçe me histori të ekspozimit të zgjatur ndaj pajisjeve digjitale që në moshë të hershme. Në mjedisin e klasës ajo komunikon kryesisht në gjuhën angleze dhe kupton vetëm disa udhëzime shumë të thjeshta në këtë gjuhë. Nuk reagon ndaj udhëzimeve të dhëna në gjuhën shqipe.

Fëmija nuk përfshihet në aktivitete të strukturuara, shmang lojën në grup dhe nuk inicon ndërveprim me bashkëmoshatarët. Vërehet vështirësi në ruajtjen e vëmendjes, mungesë e përfshirjes aktive në detyra dhe interes i kufizuar për aktivitetet edukative.

Sipas raportimeve të stafit edukativ, prindi aktualisht nuk e pranon ekzistencën e një vështirësie zhvillimore dhe refuzon referimin për vlerësim profesional.

9. Pyetje të shpeshta

PËRGJIGJE TË SHKURTRA PËR SITUATA TË ZAKONSHME

(Për mësimdhënës dhe edukatorë në klasën inkluzive)

Pyetja 1: A mund ta përkeqësojë logopedia gjendjen e fëmijës?

Përgjigje: Jo. Logopedia e bazuar në metoda shkencore dhe praktika të dëshmuara është e sigurt dhe ndihmon në përmirësimin e komunikimit, gjuhës dhe të folurit. Nuk shkakton përkeqësim të gjendjes.

Pyetja 2: Kur duhet të bëj referim për logopedi?

Përgjigje: Referimi duhet të bëhet sapo të vihen re shenja të qëndrueshme të vështirësive në komunikim. Në rast dyshimi, është gjithmonë më mirë të referohet herët sesa të pritet.

Pyetja 3: Po nëse prindërit nuk e pranojnë problemin?

Përgjigje: Qëndroni të qetë dhe ruani komunikim profesional. Dokumentoni vëzhgimet dhe bisedat me prindin. Vazhdoni mbështetjen në klasë dhe, në rastet kur vështirësitë janë të theksuara, ndiqni procedurat institucionale për referim të mëtejshëm.

Pyetja 4: Çfarë mund të bëj në klasë nëse nuk kam qasje te logopedi?

Përgjigje: Mund të përdorni strategjitë mbështetëse të komunikimit në klasë (udhëzime të thjeshta, mbështetje vizuale, modelim i gjuhës, rutina të përsëritura). Këto ndihmojnë ndjeshëm zhvillimin e fëmijës edhe pa terapi direkte.

Pyetja 5: Si duhet të reagoj kur fëmijët tallen me një bashkëmoshatar që ka vështirësi në të folur?

Përgjigje: Ndërhyni menjëherë dhe qartë. Shpjegoni se çdo fëmijë ka mënyra të ndryshme të komunikimit dhe se respekti është i domosdoshëm. Përforconi sjelljet pozitive duke lavdëruar empatinë dhe mirëkuptimin.

Pyetja 6: A është normale që disa fëmijë të flasin vonë dhe më pas të "arrijnë vetë"?

Përgjigje: Disa fëmijë mund të kenë vonesë të lehtë, por nuk është e sigurt të supozohet se problemi do të kalojë vetë. Vlerësimi i hershëm ndihmon në parandalimin e vështirësive afatgjata në të nxënë dhe komunikim.

Pyetja 7: A ndikon teknologjia në zhvillimin e të folurit?

Përgjigje: Ekspozimi i zgjatur ndaj ekraneve, sidomos pa ndërveprim verbal me të rriturit, mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e gjuhës dhe aftësive sociale.

Pyetja 8: A duhet të pres për "moshën shkollore" para referimit?

Përgjigje: Jo. Ndërhyrja e hershme (0–6 vjeç) është periudha më e rëndësishme për zhvillimin e gjuhës. Sa më herët të identifikohen vështirësitë, aq më efektive është mbështetja.

10. Referencat

BURIMET E PËRDORURA NË MANUAL

Bishop, D. V. M., Snowling, M. J., Thompson, P. A., & Greenhalgh, T. (2016). CATALISE: A multinational and multidisciplinary Delphi consensus study. PeerJ, 4, e2511.
Law, J., Charlton, J., & Asmussen, K. (2017). Language as a child wellbeing indicator. Early Intervention Foundation.
Shonkoff, J. P., et al. (2012). The lifelong effects of early childhood adversity and toxic stress. Pediatrics, 129(1), e232–e246.
Snowling, M. J., & Hulme, C. (2012). Annual research review: The nature and classification of reading disorders. Journal of Child Psychology and Psychiatry, 53(6), 593–607.
American Speech-Language-Hearing Association. (2020). Early intervention for communication disorders.

PËRFUNDIM

Për përdorim profesional

Referencat mbështesin orientimet e përgjithshme të manualit. Për vendime individuale rreth një fëmije kërkohet vlerësim i drejtpërdrejtë nga logopedi dhe profesionistët përkatës.